



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

KRYETARI I KOMUNËS

01Nr. 106/02-3976 /19
Kaçanik, 04.02.2019

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen lokale Nr.03/L-040, nenit 82 të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës Nr.03/L-149 dhe Rregullores Nr.05/2011 për procedurat e zgjidhjes së kontesteve dhe ankesave, Kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e e komisionit për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave

1. Formohet komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave në shërbimin civil, i cili ka për qëllim zhvillimin e procedurës së ankesave kundër vendimeve të komisionit diciplinor dhe kontesteve tjera .
2. Komisioni do të jetë i përbërë prej tre anëtarëve, të cilët do të kenë mandate dy vjeçar me mundësi vazhdimi dhe do të pasqyrojnë diversitetin e shoqërisë kosovare, duke përfshirë sidomos diversitetin gjinor.
3. Komisioni për zgjidhjen e kontesteve dhe ankesave ka këtë përbërje:
 1. Hamza Berisha – Kryetar i komisionit
 2. Sahadete Dalloshi - anëtar i komisionit
 3. Bujar Bajra - anëtar i komisionit
4. Komisioni do ta kryej funksionin në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore përkatëse në fuqi .
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Me këtë vendim njoftohen:

- Anëtarët e komisionit
- Njësia e personelit
- Arkivi komunal



Kryetari i Komunës
Besim Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPSTINA KAÇANIK



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

I	Data	27.02.11	Vendi	Kaçanik
Nj. org.		Numri		Shtojcë
01		100/01-5716		/

Në bazë të nenit 58 pika i. lidhur me nenin 17 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale, nenit 73, pika 1. Te Statutit të Komunës si dhe Ligjit Nr.06/L-133 per Buxhetin e Republikës se Kosoves per vitin 2019, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Mbi lejimin e mjeteve financiare:

I

Në bazë të këtij vendimi lejohet ndarja e mjeteve financiare në vlerë prej: 30,000.00 € për projektin “Ndertimi i kanalit te ujitjes ne fshatin Doganaj”

II

Vlera e mjeteve financiare nga pika 1. e këtij vendimi do te sigurohen nga programi buxhetor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimt Rural, respektivisht nga Kategoria e Investimeve Kapitale te projekti “Projektet zhvillimore per Bujqesi-Blegtori” me kod 86251, fondi burimorë 10

III

Ky vendim hyn ne fuqi në ditën e marrjes.

IV

Për zbatimin e ketij vendimi do te perkujdesen: Zyra e Kryetarit, DBPZHR, drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit dhe Zyra e Prokurimit.

V

Me kete vendim njoftohen: Zyra e Kryetarit, DEFZH, dhe DBPZHR.



Besim Ilazi,
Kryetar Komunës së Kaçanikut



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Komisioni Komunal i Aksionarëve i Ndërmarrjes Publike Komunale
"Stacioni i Autobusëve" sh.a. Kaçanik

Datë: 25.02.2019

Nr. 01-10462-5477/19

Në Mbështetje Të Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike (Ligji Nr. 04/L-111 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 Për Ndërmarrjet Publike), respektivisht nenit 16 dhe 17 të këtij ligji, nenin 171 Të Ligjit Nr. 02/L-123 Për Shoqëritë Tregtare, Udhëzimit Administrativ 03/2009 për Mënyrën e Përfaqësimit të Komunave në Bordet e Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Lokale, Vendimit të Kuvendit të Komunës së Kaçanikut 01Nr.60/01-5056/18 të datës 28.02.2018 si dhe në bazë të procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më datë 21.02.2019 të Komisionit Komunal të Aksionarëve të komunës së Kaçanikut për NPK "Stacioni i Autobusëve" sh.a. Kaçanik ,komisioni ka marrë këtë:

V E N D I M

Për emërimin e anëtarit të bordit të drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Komunale
"Stacioni i Autobusëve" sh.a. Kaçanik

- I. Emërohet z. **Agron Dema** anëtar i bordit joekzekutiv të drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Komunale "Stacioni i Autobusëve" sh.a Kaçanik,
- II. Mandati i të emëruarit është 3 (tri) vite.
- III. Obligohet i emëruari që punën e tij mandatore ta kryej në interes të kompanisë dhe komunës, në përputhje me ligjet e aplikueshme në vend.
- IV. Për punën e vet i emëruari raporton para Komisionit Komunal të Aksionarëve.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramadush Osmani

Kryesues i KKA të "Stacioni i Autobusëve" sh.a Kaçanik

Me këtë vendim njoftohen:

1. Komisioni Komunal i Aksionarëve, 2. Besim Ilazi, kryetar, 3. I emëruari z. Agron Dema 4. NPK "Stacioni i Autobusëve" sh.a Kaçanik dhe 5. Arkivi.